

RËNDËSIA E NJOHJES SË DISA GJUHËVE PËR FËMIJËT

A ka përparësi njohja e disa gjuhëve?

Po!

- Fëmijët që rriten duke ditur shumë gjuhë...
- zhvillojnë një vetëdije të fortë për gjuhën.
 - mund të përshtaten shpejt me situatat e reja.
 - mësojnë më lehtë gjuhët e tjera.
 - zakonisht janë mendje hapur për gjuhë dhe kultura të ndryshme.

A është edukimi në disa gjuhë i tepërt për fëmijën tim?

Jo!

- Fëmijët që rriten duke ditur shumë gjuhë...
- zhvillohen në mënyrë të ngjashme me fëmijët që rriten në një gjuhë.
 - mësojnë gjuhët me një ritëm të ngjashëm me fëmijët që rriten në një gjuhë.

Informacioni mbi gamën e gjerë të shërbimeve të disponueshme për familjet me fëmijë të vegjël në qytetin e Schaffhausen mund të gjendet në faqen e internetit të Departamentit të Fëmijërisë së Hershme (Fachstelle Frühe Kindheit): www.fk-stsh.ch



STADT-SCHAFFHAUSEN.CH

Stadt Schaffhausen
Fachstelle Frühe Kindheit
Postfach 1000
CH-8201 Schaffhausen
info@fk-stsh.ch
052 632 53 51



Albanisch

STADT-SCHAFFHAUSEN.CH

TË RRITESH POLIGLOT

Grëezi

ἡσπὲρ ἁρμόνια

Mirëdita

Merhaba

Good morning

Buongiorno

për familjet



TË RRITESH POLIGLOT

Fëmija juaj rritet me disa gjuhë. Falë kësaj mund të përfitojë shumë nga ana gjuhësore dhe kulturore Prandaj, përkrahni fëmijën tuaj në zbulimin e gjuhëve të ndryshme. Në qytetin e Schaffhausen, pothuajse gjysma e fëmijëve nën 4 vjeç vihen në kontakt me dy ose më shumë gjuhë në shtëpi. Njohja e disa gjuhëve është një thesar.

Në këtë broshurë do të gjeni informacion të vlefshëm për e njohjen e disa gjuhëve, si dhe gjuhën gjermane -të Zvicrës dhe atë standarde. Zgjidhni këshillat që janë të dobishme për ju dhe që i përshtaten familjes suaj. Shpresojmë t’ju vyejnë në praktikë!

VLERËSIMI I GJUHËVE

A i shpjegoni fëmijës suaj se sa të rëndësishme janë gjuhët që fliten ë familje dhe gjermanishtja?
Mësoni fëmijës suaj rëndësinë e gjuhëve!


- Gjuha e familjes suaj dhe gjermanishtja janë të rëndësishme. Falë qëndrimit tuaj pozitiv, fëmija juaj do të kënaqet me mësimin e gjuhëve.
- Tregoni interes dhe të gatshëm për të mësuar gjermanishten. Nxisni kureshtjen e fëmijës suaj.

Vlerësimi i njohjes së disa gjuhëve

Tregoni interes për të gjitha gjuhët



GJUHA AMTARE E PREFERUAR DHE EDUKIMI NË DISA GJUHË



A i flisni fëmijës suaj në gjuhën tuaj amtare (Herzenssprache)? Besojini intuitës tuaj!

- Flisni me fëmijën tuaj në gjuhën që dini më mirë– zakonisht gjuhën amtare të preferuar (Herzenssprache). Fëmija juaj do të përvetësojë një fjalor të pasur. Gjithashtu, kjo ndihmon kur mësoni gjuhë të tjera.
- Në gjuhën amtare të preferuar (Herzenssprache) ndiheni rehat dhe të sigurt. Kjo gjuhë është mënyra më e mirë për të shprehur atë që mendoni dhe ndjeni.
- Çdo prind mund të flasë me fëmijën e tij në gjuhën e tij amtare të preferuar (Herzenssprache). Përcillni vlerat emocionale dhe kulturore.

A flisni gjermanishten e Zvicrës apo atë standarde?
Mbështetni fëmijën tuaj – komunikoni gjermanisht me të!

- Përveç gjuhës amtare të preferuar (Herzenssprache), gjermanisht-ja është gjuhë e rëndësishme për fëmijën tuaj. Kjo është arsyeja pse njohuritë tuaja rreth gjermanishtes janë shumë të vlefshme!
- Përfitoni nga mundësitë që ju ofrohen në jetën e përditshme dhe komunikoni gjermanisht me fëmijën tuaj. Si rrjedhojë, fëmija juaj do të mësojë gjermanisht para se të shkojë në kopsht (Kindergarten). Kjo është shumë e rëndësishme në ditët e sotme.
- Njohuritë rreth gjermanishtes bëjnë që fëmija tuaj ta ketë më të lehtë ndjekjen e kopshtit (Kindergarten) për fëmijë dhe nxit zhvillimin e tij/saj.



A flisni më shumë se një gjuhë?
Vini në zbatim njohuritë tuaja gjuhësore!

- Nuk duhet të flisni vetëm një gjuhë: Ndryshoni gjuhën në varësi të situatës ose vendndodhjes dhe flisni gjuhën sa më natyrshëm që të jetë e mundur në jetën e përditshme.



ZHVILLIMI DHE MBËSHTETJA E GJUHËS



A komunikon fëmija juaj në gjuhë të ndryshme? Nxitni fëmijën tuaj të komunikojë në të gjitha gjuhët!

- Fëmija juaj duhet të komunikojë në gjuhë të ndryshme. Kjo është normale në fillim. Prandaj nuk ngatërrojnë gjuhët. Kjo nënkupton se ka përvetësuar shumë njohuri.
- Fëmija juaj mund të komunikojë në një gjuhë më shpesh se në një tjetër. Kjo nuk përbën asnjë problem. Si prind, vazhdoni të komunikoni rregullisht dhe lirshëm në gjuhën tuaj amtare të preferuar (Herzenssprache). Fëmija juaj arrin t’i dëgjojë fjalët dhe i përvetëson ato.

A shoqërohet fëmija juaj rregullisht me fëmijë të tjerë? Zbuloni botën me fëmijën tuaj!

- Fëmija juaj mund të bëjë shokë/shoqe në këndin e lojërave ose në lagje. Gjatë lojës, ai/ajo dëgjon dhe flet gjermanisht. Sa më herët që fëmija të jetë në kontakt me gjermanishten, aq më të lehtë do ta ketë për ta mësuar.
- Fëmija juaj bie në kontakt me fëmijët e tjerë në sallën e lojërave (Krabbelgruppe), në gjimnastikën për fëmijë (Kinderturnen) ose në grupin e lojërave (Spielgruppe). Në këtë mënyrë, ai ose ajo vazhdimisht përmirëson njohuritë e tij/saj të gjermanishtes.



A shkëmbeni ide me prindër dhe profesionistë të tjerë? Bashkohuni me ne!

- Merrni pjesë në mbledhjet e organizuara për prindër (Elternabend) në grupet e lojërave (Spielgruppe)/qendrën e kujdesit ditor (Kindertagesstätte) ose evente të dedikuara për familjet me fëmijë. Aty do të takoni familje të tjera (poliglote) dhe mund të shkëmbeni ide me to.
- Ndërttoni marrëdhënie me fqinjët.
- Flisni lirshëm me profesionistë ose prindër të tjerë për njohuritë gjuhësore të fëmijës suaj.